

TRANSPORTI NË SHIFRA 2021



TRANSPORTI NË SHIFRA 2021

Drejtor botimi: Dr. Elsa Dhuli

Punoi materialin: Irsida Nuellari dhe Alma Gaqi

© Copyright INSTAT 2023

Ndalohet riprodhimi i këtij botimi apo transmetimi i tij në cilëndo formë, pa autorizimin paraprak me shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit.

INSTITUTI I STATISTIKAVE
Rr. Vllazën Huta,
Ndërtesa 35, Hyrja 1
Tiranë, Kodi Postar 1017
Tel: + 2233356 / 2222411 4 355
Fax: 411 2222 4 355+
e-mail: info@instat.gov.al
www.instat.gov.al

Design: Gentian Suçi

TABELA E PËRMBAJTJES

PARATHËNIE	5
HYRJE	7
1. TRANSPORTI HEKURUDHOR	9
1.1 Transporti hekurudhor i mallrave	9
1.2 Transporti hekurudhor i pasagjerëve	11
2. TRANSPORTI RRUGOR	13
2.1 Infrastruktura rrugore	13
2.2 Mjetet rrugore që qarkullojnë në vend	14
2.3 Hyrje/dalje e pasagjerëve	20
3. TRANSPORTI DETAR	23
3.1 Transporti detar i mallrave	23
3.2 Transporti detar i pasagjerëve	24
4. TRANSPORTI AJROR	27
4.1 Transporti ajror i mallrave	28
4.2 Transporti ajror i pasagjerëve	28
5. SIGURIA NË TRANSPORT	30
5.1 Aksidente hekurudhore	30
5.2 Aksidente rrugore	30
6. SHPJEGIME METODOLOGJIKE	34



PARATHËNIE

Instituti i Statistikave (INSTAT), boton për herë të parë një publikim të veçantë për treguesit kryesorë të transportit. Transporti është një sektor i rëndësishëm i ekonomisë dhe luan një rol jetik në shoqërinë e sotme të lëvizshme.


Ky publikim i dedikuar, paraqet me anë të shifrave situatën reale në vend, si dhe përgjigjet ndaj kërkesave në rritje për informacion statistikor të vendimarrësve, kërkuesve shkencor dhe akademikëve në Shqipëri. Përgatitja e këtij materiali është mundësuar nga burime administrative të treguesve statistikorë lidhur me transportin hekurudhor, rrugor, detar dhe ajror lidhur me sasinë e mallrave dhe numrin e pasagjerëve që lëvizin çdo vit, mjetet e përdorura, si dhe treguesit e sigurisë në transport.

Bashkëpunimi me institucionet e tjera dhe politikë-bërësit, rrit përgjegjësinë e INSTAT për hartimin e publikimeve të veçanta dhe informacioneve statistikore të cilat shërbejnë për të njohur më mirë realitetin, monitoruar atë dhe për të përballuar sfidat e së ardhmes.

INSTAT gjithmonë do të ofrojë partneritet të vazhdueshëm dhe një bashkëpunim të frytshëm, ashtu siç e dëshmon dhe ky botim!

Dr. Elsa DHULI

Drejtor i Përgjithshëm, INSTAT





HYRJE

Transporti dhe lëvizshmëria janë thelbësore për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Transporti i qëndrueshëm ndikon në rritjen ekonomike dhe në përmirësimin e aksesueshmërisë duke respektuar mjedisin dhe duke përmirësuar qëndrueshmërinë e qyteteve, lidhjet urbane-rurale dhe produktivitetin e zonave rurale.

Materiali i përgatitur nga Instituti i Statistikave (INSTAT) përfshin të dhëna referuar vitit 2021 dhe do të jetë një publikim i qëndrueshëm dhe vazhdueshëm, i cili do të paraqesë në frekuencë vjetore, ecurinë dhe trendin e zhvillimit të sektorit të Transportit në Shqipëri.

Materiali përbëhet nga 5 kapituj:

- Kapitulli i parë paraqet të dhëna për transportin hekurudhor, i përfaqësuar nga volumi i mallrave, pasagjerëve si dhe mjetet hekurudhore të përdorura në këtë transport.
- Kapitulli i dytë paraqet të dhëna për transportin tokësor i përfaqësuar nga rrjeti rrugor në vend si dhe mjetet rrugore që qarkullojnë në vendin tonë.
- Kapitulli i tretë paraqet të dhëna për transportin detar, i përfaqësuar nga volumi i mallrave dhe pasagjerëve, numri i anijeve të hyra/dala si dhe llojet e mallrat e transportuara me anije.
- Kapitulli i katërt paraqet të dhëna për transportin ajror i përfaqësuar nga volumi i mallrave, postës dhe pasagjerëve si dhe treguesit specifikë të transportit ajror.
- Kapitulli i pestë paraqet të dhëna për sigurinë në transport në të cilin përfshihen aksidentet hekurudhore dhe rrugore.

Treguesit e transportit janë siguruar nga burime administrative në vend sipas specifikave të vetë llojit të transportit. Transmetimi pranë INSTAT kryhet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Të dhënat dhe treguesit e transportit hekurudhorë sigurohen nga Hekurudha Shqiptare Sh.a dhe operatorët privatë që operojnë në këtë sektor; për transportin tokësor të dhënat sigurohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor; për transportin detar të dhënat sigurohen nga portet detare në vend; për transportin ajror të dhënat sigurohen nga aeroportet kombëtare/ndërkombëtare në vend.



TRANSPORTI HEKURUDHOR

1. TRANSPORTI HEKURUDHOR

Gjatësia e rrjetit hekurudhor në shfrytëzim në vend është 224 km. Në shfrytëzim janë linjat hekurudhore: Durrës – Librazhd 100 km, Gjorm - Kufi 93 km, Durrës - Kashar 31 km.

Transporti hekurudhor i mallrave kryhet në distanca 0-49 km dhe 50-150 km. Volumi i mallrave që transportohet sipas distancës 50-150 km është 66,5 mijë ton, ose 88,3 % e mallrave të transportuara me transport hekurudhor.

Gjatësia e linjave në shfrytëzim krahasuar me vitin 2020 nuk paraqitet me ndryshim (ndikuar nga Covid 19), por krahasuar me vitin 2019 gjatësia e linjave në shfrytëzim është rritur 32,5 %.

Tabela 1: Dëndësia e rrjetit hekurudhor për km² sipërfaqe

Treguesit	2019	2020	2021
Gjatësia e linjave në shfrytëzim	169	224	224
Dëndësia e rrjetit hekurudhor, (ml/km² sipërfaqe)	5,9	7,8	7,8


Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje INSTAT

1.1 Transporti Hekurudhor i mallrave

Transporti hekurudhor i mallrave rezultoi 25,11 milionë ton-km në vitin 2021, i cili krahasuar me vitin 2020 paraqitet me rënie prej 3,5 %.

Transporti kombëtar hekurudhor zë 88,0 % të transportit gjithsej të mallrave të transportuar me hekurudhë (kombëtar + ndërkombëtar).

Grafiku 1: Transporti hekurudhor i mallrave, 2021 (në milion ton-km)




Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje INSTAT

Deri në vitin 2015, transporti hekurudhor i mallrave realizohej vetëm nga Hekurudha Shqiptare sh.a ndërkohë në vitin 2016, filluan të operojnë edhe subjekte private në transportin hekurudhor të mallrave.

Në 2021, transporti i kryer nga subjektet private zë pjesën më të madhe të transportit hekurudhor të mallrave në vend me 88% në ton dhe 77% në ton-km.

Mallrat e transportuar klasifikohen sipas Klasifikimit Standart Evropian (NST 2007), i zbatuar në Shqipëri prej vitit 2019. Sipas klasifikimit NST 2007, 88,1 % e mallrave të transportuar me hekurudhë e zënë qymyri dhe linjiti, nafta bruto dhe gazi natyror si dhe 10,2 % janë produkte metalike dhe të minierave dhe produkte të tjera të guroveve.

Grafiku 2: Transporti hekurudhor i mallrave sipas llojit të mallrave, viti 2021



Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje INSTAT


Në lidhje me shkëmbimet tregtare me hekurudhë (import+eksport) në vitin 2021, janë shkëmbyer me jashtë 33,4 mijë ton mallra nga të cilat 11,3 mijë ton janë shkëmbyer me Malin e Zi.

1.2 Transporti Hekurudhor i pasagjerëve

Në vitin 2021, 24.018 pasagjerë kanë përdorur transportin hekurudhor si mjet për udhëtim, ku krahasuar me një vit më parë numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar me këtë lloj transporti është rritur me 33,8 %.

Në grafikun më poshtë paraqitet numri i pasagjerëve për km, për periudhën kohore 2019-2021.

Grafiku 3: Numri i pasagjerëve në transportin hekurudhor, 2019-2021 (në 000 pasagjerë për km)



Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje INSTAT



TRANSPORTI
RRUGOR

2. TRANSPORTI RRUGOR

2.1 Infrastruktura rrugore

Gjatësia e rrjetit rrugor në shfrytëzim në vitin 2021 është 3.606 km, sipas kategorive të ndryshme, si autostradë, rrugë interurbane apo urbane dhe rrugë lokale. Në tabelën e mëposhtme paraqitet gjatësia e rrjetit rrugor në shfrytëzim sipas klasifikimit të Kodit rrugor:


Kategoritë e rrugëve*	Njësia matëse (km)
Gjithsej	3.606
Autostradë	24,7
Rrugë interurbane kryesore	260
Rrugë interurbane dytësore	2675,8
Rrugë urbane kryesore	9,6
Rrugë urbane dytësore	48,5
Rrugë lokale	587,4

Burimi: Autoritetit Rrugor Shqiptar, Ilogaritje INSTAT

*Kategoritë e rrugëve sipas klasifikimit të Kodit rrugor në Shqipëri

Në vitin 2021, densiteti për 100 km² është 12,5 nga 12,8 në vitin 2020 dhe 12,9 % në vitin 2019.

Grafiku 4: Densiteti i rrugëve për 100 km², 2019-2021



Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ilogaritje INSTAT


2.2 Mjetet rrugore që qarkullojnë në vend

Numri gjithsej i mjeteve rrugore me status “aktiv” dhe “të çregjistruar përkohësisht” që qarkullojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë rezulton 740.669 mjete, nga 676.811 mjete të regjistruara deri në vitin 2020, duke u rritur me 9,4 %.

Në kategorinë e mjeteve rrugore sipas llojit, përqindjen më të madhe ndaj numrit gjithsej të mjeteve rrugore e zënë “Autoveturat” (80,1 %), ndërkaj “Automjetet për transport të përzier” zënë (6,7 %) dhe “Motor” zënë (5,1 %).

Shkalla e motorizimit, matet me numrin e autoveturave për 1.000 banorë, tregues i cili ndër vite ka ardhur me rritje. Në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020 është rritur me 11,4 % dhe krahasuar me vitin 2019 është rritur me 20,9 %.

Grafiku 5: Numri i autoveturave për 1.000 banorë



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, përlogaritje të INSTAT

Në tabelën e mëposhtme jepet informacion i detajuar për periudhën kohore 2020- 2021 në lidhje me mjetet rrugore sipas llojit dhe trendi i tyre në përqindje. Rritjen më të lartë e paraqet kategoria “Rimorkio për transport të veçantë” me 13,9 %, pasuar nga kategoria “Motor” me 11,9 % rritje dhe kategoria “Autovetura” me 10,0 % rritje ndaj vitit 2020.

Tabela 2: Mjetet rrugore sipas llojit, 2020 - 2021


Lloji i mjetit rrugor	2020	2021	2021/2020 %
Gjithsej	676.811	740.699	9,4
Autoveturë	539.497	593.280	10,0
Automjet për transport të përzier	46.844	49.596	5,9
Motor	33.899	37.931	11,9
Kamion	13.819	14.404	4,2
Autobus	7.627	7.867	3,1
Automjet për transport të veçantë	6.860	7.411	8,0
Ciklomotor	6.661	6.436	-3,4
Gjysëm rimorkio	6.361	6.759	6,3
Tërheqës	4.763	5.138	7,9
Automjet për përdorim të veçantë	3.755	3.977	5,9
Makinë bujqësore	1.743	1.673	-4,0
Rimorkio për transport mallrash	1.527	1.659	8,6
Makinë teknologjike	874	819	-6,3
Motokarro	819	808	-1,3
Rimorkio për transport të veçantë	598	681	13,9
Kategori të tjera	1.164	2.230	91,6

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, përlogaritje të INSTAT

Numri më i lartë i mjeteve rrugore është regjistruar në qarkun e Tiranës, duke zënë 35,0 % ndaj mjeteve rrugore gjithsej të regjistruara në vend në vitin 2021.


Qarqet me numrin më të vogël të mjeteve rrugore janë qarku Dibër dhe Gjirokastrë me 2,3 % secili ndaj mjeteve rrugore gjithsej.

Grafiku 6: Struktura e mjeteve rrugore sipas qarqeve, 2021 (%)



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, përlogaritje të INSTAT


Grafiku 7: Numri i autoveturave sipas qarqeve dhe ndryshimi në përqindje, 2020-2021



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, përlogaritje të INSTAT

Në kategorinë e autoveturave, sipas tipologjisë së kambios, manuale, automatike apo semi-automatike, rezulton se autoveturat me kambio "Manuale" zënë pjesën më të madhe me 62,6 % të autoveturave gjithsej.


Grafiku 8: Autoveturat sipas kambios, 2021 (%)



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, përlogaritje të INSTAT

Në kategorinë e autoveturave, sipas moshës, autoveturat me moshë 11-20 vite përbëjnë 54,2 % të numrit gjithsej të autoveturave.


Grafiku 9: Autovetura të grupuara sipas moshës, 2021 (%)



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, përlogaritje të INSTAT

Marka "Mercedes Benz" është marka me qarkullim më të lartë në vend në kategorinë e autovecurave me 18,2%, e ndjekur nga marka "Volkswagen" me 17,5 % dhe "Daimler Chrysler" 10,9 %.

Grafiku 10: Mjete rrugore sipas markës, 2021 (%)



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, përlogaritje të INSTAT

Në vitin 2021, marka "Mercedes Benz" regjistrohet si marka më e përdorur e autovecurave të regjistruara me vit prodhimi para 2000 dhe viteve 2011-2021. Marka "Volkswagen" regjistrohet si marka më e përhapur e autovecurave me vit prodhimi 2000-2010.


Tabela 3: Autovecura sipas markës dhe viteve të prodhimit, 2021 (%)

<2000	%	2000-2010	%	2011-2021	%
MERCEDES BENZ	35,3	VOLKSWAGEN	17,8	MERCEDES BENZ	21,3
VOLKSWAGEN	17,5	DAIMLER CHRYSLER	14,9	VOLKSWAGEN	15,5
FORD	7,5	MERCEDES BENZ	11,7	AUDI	8,7
OPEL	5,7	FORD	11,1	FORD	6,5
DAIMLER CHRYSLER	4,4	OPEL	5,7	HYUNDAI	6,3
AUDI	4,0	AUDI	5,4	SKODA	4,9
FIAT	3,8	TOYOTA	5,6	BMW	5,0
RENAULT	3,0	FIAT	4,1	LAND ROVER	4,3
DAIMLER BENZ	2,8	BMW	3,4	TOYOTA	3,3
BMW	2,3	RENAULT	2,9	FIAT	3,1
TË TJERA	13,7	TË TJERA	17,4	TË TJERA	21,1

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, përlogaritje të INSTAT

Në kategorinë e autoveturave, sipas lëndës djegëse numri më i madh i autoveturave që kanë qarkulluar në vendin tonë deri në Dhjetor të vitit 2021 kanë përdorur lëndë djegëse "Naftë" duke u rritur me 0,1 pikë përqindje krahasuar me vitin 2020.


Grafiku 11: Autovetura sipas lëndës djegëse, 2021 (%)



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, përlogaritje të INSTAT

Në kategorinë e autoveturave, sipas vëllimit motorrik, në vitin 2021 rezulton që 67,2 % e autoveturave kanë vëllim motorrik ≤ 2000 cc. Autoveturat me vëllim motorrik mbi 3000 cc zënë vetëm 2,6 % të numrit të autoveturave gjithsej.

Grafiku 12: Autovetura sipas vëllimit motorrik, 2021 (%)



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, përlogaritje të INSTAT

Vëllimi në cc më i përhapur te autoveturat me lëndë djegëse "Benzinë" është 1400 cc-1999 cc duke zënë 53,4% gjithsej me lëndë djegëse benzinë.

Vëllimi në cc më i përhapur te autoveturat me lëndë djegëse "Naftë", është nën 1399 cc duke zënë 61,4 % të autoveturave gjithsej me lëndë djegëse naftë.

Tabela 4: Autovetura sipas lëndës djegëse dhe vëllimit, 2021

Vëllimi	Autovetura me Benzinë	Autovetura me Naftë
Autovetura Gjithsej	436.756	102.432
<1399 CC	29.964	62.915
1400 CC - 1999 CC	233.286	28.710
>2000 CC	173.506	10.807

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, përlogaritje të INSTAT

2.3 Lëvizja e pasagjerëve nëpërmjet transportit rrugor

Të dhënat mbi numrin e pasagjerëve që kanë udhëtuar nëpërmjet transportit rrugor përfshijnë hyrjet dhe daljet e pasagjerëve në pikat kufitare tokësore në vend.

Numri i pasagjerëve të hyrë dhe të dalë nëpërmjet transportit rrugor në pikat kufitare tokësore rezultoi 15.397.665 në vitin 2021. Ky numër paraqitet me rritje 1,7 herë krahasuar me vitin 2020. Rreth 43,1 % e pasagjerëve kanë lëvizur nëpërmjet pikës kufitare tokësore Morinë.

Tabela 5: Pasagjerë të hyrë dhe të dalë nga pikat kufitare tokësore, 2020-2021

Pikat kufitare tokësore	2020		2021	
	Hyrje	Dalje	Hyrje	Dalje
Gjithsej	4.528.412	4.670.958	7.664.197	7.733.468
Qafë Botë	73.691	122.321	117.480	115.041
Rips	1.048	1.124	0	0
Kakavijë	347.143	355.286	453.528	433.341
Sopik	2.669	2.676	2.514	3.011
Tri Urat	6.096	7.618	8.981	9.681
Kapshticë	299.986	309.211	374.168	304.138
Goricë	101.666	99.861	105.319	137.903
Tushemisht	60.452	62.863	100.800	98.637
Qafë Thanë	559.933	525.457	792.141	709.776
Bllade	216.283	220.378	256.742	268.828
Shishtavec	14.551	14.156	43.674	50.257
Orgjost	23.160	23.345	38.138	39.488
Morinë	1.754.200	1.840.183	3.258.287	3.372.296
Qafë Prush	137.196	142.080	182.120	206.534
Qafë Morinë	184.005	181.026	255.863	274.171
Bashkim	14.408	13.096	66.832	61.790
Hani Hotit	356.128	362.227	603.807	584.396
Vicisht	19.455	19.412	40.404	40.350
Ura e Bunës	191	191	0	0
Muriqan	356.151	368.447	963.399	1.023.830

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, llogaritjet INSTAT



TRANSPORTI DETAR

3. TRANSPORTI DETAR

3.1 Transporti Detar i mallrave

Shqipëria ka katër porte detare, të cilat shërbejnë për transport mallrash, të cilat janë Porti i Durrësit, Vlorës, Shëngjinit dhe porti i Limjonit (Sarandë).

Porti i Durrësit është porti kryesor në vend nga i cili janë transportuar 91,7 % e volumit të mallrave të transportuar me det, ose 4.438,6 mijë ton mallra. Në vitin 2021, volumi gjithsej i mallrave të transportuara nga porti i Durrësit është rritur me 14,3% krahasuar me vitin 2020.

Tabela 6: Volumi i mallrave sipas porteve detare, 2020-2021

	Viti 2020	Viti 2021	Ndryshimi në %
Gjithsej	4.277	4.840	13,2
Porti Durrës	3.882	4.439	14,3
- Import	2.866	3.094	8,0
- Eksport	1.016	1.345	32,3
Porti Vlorë	102	122	18,8
- Import	66	71	7,3
- Eksport	36	51	39,6
Porti Limjoni (Sarandë)	59	41	-29,3
- Import	19	15	-17,9
- Eksport	40	26	-34,6
Porti Shëngjin	234	238	1,9
- Import	195	183	-6,4
- Eksport	38	55	44,4

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje INSTAT


Lidhur me llojet e mallrave të transportuara me det, sipas klasifikimit NST 2007, për vitin 2021:

- Grupi i mallrave “Produkte të tjera minerale (jo metalike)” përbën 14,1 % të mallrave të transportuar gjithsej nga portet;
- Grupi “Metale bazë, produkte metalike të fabrikuara, përveç makinerive dhe pajisjeve” përbën 12,0 % të mallrave të transportuara me det;
- Grupi “Qymyr dhe linjit; naftë bruto dhe gaz natyror” përbën 7,3% të mallrave të transportuara nga portet.

Krahasuar me vitin 2020, të tre grupet kryesore të mallrave paraqiten me rritje.

Grupi “Metale bazë, produkte metalike të fabrikuara, përveç makinerive dhe pajisjeve” paraqitet me rritjen më të lartë me 30,0 %, grupi “Qymyr dhe linjit; naftë bruto dhe gaz natyror” me 22,6 % dhe grupi “Produkte të tjera minerale (jo metalike)” me 18,1 %.

Grafiku 13: Transporti detar i mallrave sipas llojit të mallrave, 2021 (në %)



Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, llogaritje INSTAT

Numri i anijeve të hyra dhe të dala nga portet në vend rezulton 830 anije, nga këto 142 anije janë vendase dhe 688 anije janë të huaja. Numri i anijeve të hyra dhe të dala në porte është rritur me 9,1 % krahasuar me vitin 2020, ku numri i anijeve të huaja është rritur me 12,4 % krahasuar me vitin 2020.

Numri i kontenierëve të ngarkuar e shkarkuar në portin e Durrësit në vitin 2021 është 144.129 TEU duke u rritur me 4,1 % krahasuar me vitin 2020.


3.2 Transporti Detar i pasagjerëve

Portet detare ku kryhet transport pasagjerësh në vend janë: Porti i Durrësit, Vlorës, Shëngjinit dhe porti i Sarandës. Lëvizja e pasagjerëve për vitin 2021 është kryer vetëm nga porti i Durrësit, Vlorës dhe porti i Sarandës.

Në vitin 2021, numri i pasagjerëve që kanë udhëtuar nëpërmjet porteve detare në vend është 862.757 duke shënuar rritje me 2.3 herë krahasuar me 2020.

Porti i Durrësit është porti kryesor në vend nga i cili kanë udhëtuar 79,8 % e pasagjerëve, më pas vjen porti i Vlorës me 12,8 %, porti i Sarandës me 7,4 %.

Grafiku 14: Transporti detar i pasagjerëve sipas porteve detare, 2019-2021 (në numër)



Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ilogaritje INSTAT



TRANSPORTI
AJROR


4. TRANSPORTI AJROR

Në transportin ajror kanë operuar 20 shoqëri ajrore, nga këto 18 janë shoqëri të huaja.

Në hapësirën ajrore shqiptare kanë fluturuar 155.544 avionë.

Linjat e rregullta përbëjnë 73 % të ulje ngritjeve të avionëve sipas llojit të tyre ndjekur nga charter me 26% dhe avionë ushtarakë 1%.


Grafiku 15: Struktura në përqindje e avionëve sipas llojit, 2021



Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ilogaritje INSTAT

Gjatë vitit 2021, numri i mbikalimeve në hapësirën ajrore shqiptare rezultoi 129.210, duke u rritur me 48,2 % krahasuar me vitin 2020.

Grafiku 16: Dinamika në transportin ajror, 2020-2021




Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ilogaritje INSTAT

4.1 Transporti Ajror i mallrave

Volumi i mallrave (duke përfshirë postën) të hyrë dhe të dalë nëpërmjet transportit ajror rezultoi 2.036 ton, nga të cilat 77,7 % janë mallra të hyrë dhe 22,3 % janë mallra të dalë nëpërmjet transportit ajror. Krahasuar me vitin 2020, volumi i mallrave paraqitet me rritje prej 13,3 %.

Grafiku 17: Volumi i mallrave dhe postës në transportin ajror në vend, 2021 (në ton)




Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ilogaritje INSTAT

Në transportin ajror, posta zë 13,1 % të volumit gjithsej të mallrave të transportuar me ajër. Krahasuar me vitin 2020, posta paraqitet me ulje prej -6,5 %.

4.2 Transporti Ajror i pasagjerëve

Gjatë vitit 2021, kanë udhëtuar me linja ajrore 2.928.275 pasagjerë. Ky numër është rritur 2,2 herë krahasuar me vitin 2020. Numri i pasagjerëve të hyrë dhe të dalë nëpërmjet linjave ajrore ka sjellje të njëjtë.

Grafiku 18: Numri i pasagjerëve të hyrë dhe të dalë me rrugë ajrore sipas kombësisë, 2020-2021



Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ilogaritje INSTAT



SIGURIA NË
TRANSPORT

5. SIGURIA NË TRANSPORT

5.1 Aksidente Hekurudhore

Gjatë vitit 2021, janë regjistruar 5 aksidente hekurudhore dhe në ngjarje është përfshirë 1 person. Shkaku i ndodhjes së aksidenteve ka qënë sjellja e qytetarëve. Rreth 40 % e aksidenteve hekurudhore kanë ndodhur ditën e Shtunë.

Tabela 7: Numri i aksidenteve hekurudhore sipas sjelljes, 2020-2021

Sipas shkaktit të ndodhjes	2020	2021
Sjellja e mashinistit	0	0
Sjellja e qytetarëve	3	5

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ilogaritje INSTAT

Tabela 8: Numri i aksidenteve hekurudhore sipas ditëve të javës, 2020-2021

Sipas ditëve të javës	2020	2021
E hënë	1	1
E martë	0	0
E mërkurë	0	0
E enjte	0	1
E premte	1	1
E shtunë	1	2
E diel	0	0

Burimi: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ilogaritje INSTAT

5.2 Aksidente Rrugore

Në vitin 2021, janë regjistruar 1.376 aksidente rrugore, nga të cilat ka rezultuar 1,860 persona të përfshirë në aksidente. Në 84,7 % të rasteve, numri i aksidenteve ka ndodhur si pasojë e sjelljes së drejtuesit të mjetit. Numri më i lartë i aksidenteve ka ndodhur në qarkun e Tiranës (733) dhe në qarkun e Lezhës (255). Individët me mbi 9 vite leje drejtimi kanë shkaktuar 38,2 % të aksidenteve, pasuar nga kategoria me deri 3 vjet leje drejtimi që zë 19,5 %. Dita e Premte shënon ditën e javës me më shumë aksidente, 210 ose 6,1 % e aksidenteve. Numri i aksidenteve më i lartë ka ndodhur gjatë intervalit kohor 19:00-24:00.

Tabela 9: Numri i Aksidenteve sipas sjelljes, 2020-2021

	2020	2021	Ndryshimi në %
Gjithsej	1.234	1.376	11,5
Aksidente si pasojë e sjelljes së drejtuesit të mjetit	1.055	1.166	10,5
Aksidente si pasojë e sjelljes së këmbësorëve	179	210	17,3


Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Ilogaritjet INSTAT

Tabela 10: Numri i Aksidenteve sipas qarqeve, 2020-2021

Qarku	2020	2021	Ndryshimi në %
Berat	14	33	135,7
Dibër	52	22	-57,7
Durrës	116	114	-1,7
Elbasan	62	57	-8,1
Fier	93	118	26,9
Gjirokastrë	47	86	83,0
Korçë	76	59	-22,4
Kukës	30	49	63,3
Lezhë	122	168	37,7
Shkodër	26	26	0,0
Tiranë	574	627	9,2
Vlorë	22	17	-22,7
Gjithsej	1.234	1.376	11,5

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Ilogaritjet INSTAT

Grafiku 19: Ndryshimi në përqindje i aksidenteve sipas qarqeve, 2020-2021



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Ilogaritjet INSTAT

Tabela 11: Aksidente rrugore sipas eksperiencës në drejtim, 2020-2021

	2020	2021	Ndryshimi në %
Pa leje drejtimi	63	87	38,1
0 - 3 vjet	201	269	33,8
3 - 6 vjet	289	206	-28,7
6 - 9 vjet	168	203	20,8
Mbi 9 vjet	428	525	22,7
Larguar nga vendi i ngjarjes	85	86	1,2

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Ilogaritjet INSTAT

Tabela 12: Aksidente rrugore sipas ditëve të javës, 2020-2021

	2020	2021	Ndryshimi në %
E Hënë	186	191	2,7
E Martë	168	175	4,2
E Mërkurë	207	196	-5,3
E Enjte	172	200	16,3
E Premte	178	210	18,0
E Shtunë	159	206	29,6
E Dielë	164	198	20,7

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Ilogaritjet INSTAT

Tabela 13: Aksidente rrugore sipas Orës së ndodhjes së aksidentit, 2020-2021

	2020	2021	Ndryshimi në %
00.00 - 06.00	54	65	20,4
06.00 - 08.00	82	82	0,0
08.00 - 12.00	256	288	12,5
12.00 - 14.00	179	190	6,1
14.00 - 17.00	224	257	14,7
17.00 - 19.00	206	193	-6,3
19.00 - 24.00	233	301	29,2

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, Ilogaritjet INSTAT

H
D
-
H

1 0 0 7 1 1 8 0 1 7

0 0 0 6 5 2 0 6 1 5 1 9 0 7 5 9 C 0 0

0 0 0 6 5 2 0 6 1 5 1 9 0 7 5 9 C 0 0

0 0 0 6 5 2 0 6 1 5 1 9 0 7 5 9 C 0 0

0 0 0 6 5 2 0 6 1 5 1 9 0 7 5 9 C 0 0

0 0 0 6 5 2 0 6 1 5 1 9 0 7 5 9 C 0 0

0 0 0 6 5 2 0 6 1 5 1 9 0 7 5 9 C 0 0

0 0 0 6 5 2 0 6 1 5 1 9 0 7 5 9 C 0 0

0 0 0 6 5 2 0 6 1 5 1 9 0 7 5 9 C 0 0

0 0 0 6 5 2 0 6 1 5 1 9 0 7 5 9 C 0 0

0 0 0 6 5 2 0 6 1 5 1 9 0 7 5 9 C 0 0

0 0 0 6 5 2 0 6 1 5 1 9 0 7 5 9 C 0 0

0 0 0 6 5 2 0 6 1 5 1 9 0 7 5 9 C 0 0

0 0 0 6 5 2 0 6 1 5 1 9 0 7 5 9 C 0 0

0 0 0 6 5 2 0 6 1 5 1 9 0 7 5 9 C 0 0

SHPJEGIME

METODOLOGJIKE

6. SHPJEGIME METODOLOGJIKE

Të dhënat e publikimit "Transporti në shifra" sigurohen nga burime administrative. Përgatitja e këtij materiali është mundësuar nga burime administrative të cilat sigurojnë një rrjet të gjerë informacioni mbi llojet e ndryshme të transportit në vend. Treguesit e Transportit hekurudhorë sigurohen nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ku burim informacioni janë të dhënat e raportuara nga Hekurudha Shqiptare Sh.a dhe operatorët privatë, për transportin tokësor të dhënat sigurohen nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ku burim informacioni janë të dhënat e raportuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, për transportin detar të dhënat sigurohen nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ku burim informacioni janë të dhënat e raportuara nga portet detare në vend si dhe për transportin ajror të dhënat sigurohen nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ku burim informacioni janë të dhënat e raportuara nga aeroportet kombëtare në vend.

Të dhënat e statistikave të transportit mbulojnë të gjithë territorin e vendit. Për klasifikimin e mallrave sipas mënyrave të ndryshme të transportit përdoret Klasifikimi Standard i Mallrave për Statistikat e Transportit, NST 2007.

PËRKUFIZIME:

Transporti Hekurudhor

Çdo lëvizje e mallrave dhe/pasagjerëve duke përdorur mjete me rrota të drejtuar mbi binarë.

Gjatësia e shinave: Për një seksion të caktuar hekurudhor është gjatësia midis pikës së mesme të ndërtesës së stacionit të nisjes dhe pikës së mesme të ndërtesës së stacionit të terminalit.

Pasagjerë të transportuar me hekurudhë: Çdo pasagjerë që udhëton me mjetin hekurudhor, duke përfshirë personat e destinuar për shërbime në tren.

Ton-kilometër (TKM): Njësia e matjes që përfaqëson lëvizjen e një ton kapaciteti të disponueshëm në një vagon kur kryhet shërbime për të cilat është përcaktuar një distancë kryesisht mbi një kilometër.

Mallra të transportuara me hekurudhë: Çdo lëvizje malli që kryhet me mjet hekurudhor, duke përfshirë këtu ambalazhin dhe pajisjet siç janë kontenierët, paletet si dhe mjetet rrugore të mallrave të transportuara me hekurudhë.

Tren-kilometër: Distanca në kilometra të përkrahura nga trenat.

Transporti Rrugor

Autostradë: Rrugë interurbane ose urbane me karrexhata të pavarura ose të ndara nga trafikndarës të pakapërcyeshëm, secila me të paktën dy korsi lëvizjeje, bankinë të shtruar të mundshme në të majtë dhe korsi emergjence, ose bankinë të shtruar në të djathtë, pa kryqëzime në nivel, e pajisur me rrethim dhe sisteme asistence për përdoruesin gjatë gjithë gjatësisë, e rezervuar për qarkullimin e disa kategorive mjeteve me motor dhe e dallueshme me sinjale të veçanta të fillimit dhe mbarimit.

Rrugë interurbane kryesore: Rrugë me karrexhata të pavarura ose të ndara nga trafikndarës të pakapërcyeshëm, secila me të paktën dy korsi lëvizjeje dhe bankina të shtruar, pa kryqëzime në nivel, me hyrje të koordinuara për objekte anësore, e dallueshme nga sinjale të veçanta të fillimit dhe mbarimit, e rezervuar për qarkullimin e disa kategorive mjeteve me motor.

Rrugë interurbane dytësore: Rrugë me një karrexhatë me të paktën një korsi lëvizjeje për sens dhe bankina.

Rrugë urbane kryesore: Rrugë me karrexhata të pavarura, ose të ndara nga trafikndarës, secila me të paktën dy korsi lëvizjeje dhe një korsi e mundshme e rezervuar për mjete publike, bankina të shtruara dhe trotuare, me kryqëzime në nivel të pajisura me semafor. Për qëndrimin janë parashikuar zona ose breza anësore jashtë karrexhatës, të dyja me hyrje dhe dalje të përqendruara.

Rrugë urbane dytësore: Rrugë me një karrexhatë me të paktën dy korsi, bankina të shtruara dhe trotuare. Për qëndrimin janë parashikuar zona të pajisura me korsi manovrimi jashtë karrexhatës.

Rrugë lokale: Rrugë urbane ose interurbane, e sistemuar në mënyrë të përshtatshme sipas përkufizimeve të pikës 1 të këtij neni, por që nuk bën pjesë në rrugët e mësipërme.

Automjete për transport të përzier (ATP): Mjete që kanë një peshë të përgjithshme me ngarkesë të plotë jo më të madhe se 3.5 tonë, ose 4.5 tonë kur ka tërheqje elektrike me bateri; janë të destinuara për transport njerëzish dhe mallrash me kapacitet maksimal nëntë ndenjës, duke përfshirë dhe ndenjësën e drejtuesit të mjetit.

Automjete për përdorim të veçantë (APV): Mjete të pajisura në mënyrë të përhershme me mekanizma të veçantë dhe të destinuar përgjithësisht për transportin e këtyre mekanizmave; mbi këto automjete lejohet transporti i personelit dhe i materialeve që kanë lidhje me ciklin operativ të këtyre mekanizmave, si dhe transporti i njerëzve dhe mallrave që kanë lidhje me destinacionin e përdorimit të këtyre mekanizmave.

Automjete për transport të veçantë (ATV): Mjete transporti të destinuar për transportin e disa mallrave ose njerëzve të caktuar në kushte të veçanta dhe karakterizohet nga pajisja në mënyrë të përbashkët, me mekanizma special që i shërbejnë këtij qëllimi.

Shkalla e motorizimit: Numri i autovegurave për pasagjerë të regjistruar për 1000 banorë.

Hyrjet e pasagjerëve: Përfshijnë të gjitha hyrjet e pasagjerëve në pikat kufitare tokësore. Hyrjet janë një koncept që i referohet të gjitha mbërritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Daljet e pasagjerëve: Përfshijnë të gjitha daljet e pasagjerëve nga pikat kufitare tokësore. Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës. Një person që lë vendin e referencës disa herë gjatë një viti llogaritet çdo herë si një dalje e re.

Transporti Detar

Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur anije tregtare në udhëtime të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me det.

Port statistikor: Një port statistikor përbëhet nga një ose më shumë porte, të kontrolluara normalisht nga një autoritet i vetëm porti, në gjendje të regjistrojë lëvizjet e anijeve dhe ngarkesave.

Porti i ngarkimit: Porti ku mallrat ngarkohen në anije dhe transportohen prej saj.

Porti i shkarkimit: Porti ku mallrat janë shkarkuar nga anija pasi janë transportuar prej saj.

Transport ndërkombëtar detar: Transporti detar mes dy porteve i lokalizuar në dy vende të ndryshme.

Pasagjerë detar: Çdo person që kryen një udhëtim në det në një anije tregtare.

Pasagjerë të embarkuar (të dalë): Janë pasagjerë të cilët kanë hipur në anije dhe transportohen prej saj.

Pasagjerë të disembarkuar (të hyrë): Janë pasagjerë të zbritur nga anija pasi janë transportuar prej saj.

Pasagjerë/kilometër: Njësia e matjes që përfaqëson lëvizjen e një pasagjeri në një anije tregtare mbi një kilometër.

TEU- Njësi statistikore e bazuar në kontenerët ISO me një lartësi 6.1 m (20 feet) për të siguruar një masë të standartizuar të kontenerëve me kapacitete të ndryshme dhe për përshkrimin e kapaciteteve të kontenerëve në anije. 6.1m (20 feet) = 1 TEU.

Transporti Ajror

Çdo lëvizje e mallrave dhe/ose pasagjerëve duke përdorur avionë në udhëtime të cilat ndërmerren tërësisht ose pjesërisht me ajër.

Aeroport: Një zonë e caktuar e tokës ose ujit (përfshirë ndërtesat, instalimet dhe pajisjet) të destinuara për t'u përdorur qoftë tërësisht ose pjesërisht për mbërritjen, nisjen dhe lëvizjen sipërfaqësore të avionëve dhe të hapur për operacionet tregtare të transportit ajror.

Linjë ajrore: Një ndërmarrje aviacioni që operon aeroplanët për qëllime tregtare që (i) kryen shërbime të planifikuara të transportit ajror, ose të dy, të cilat janë në dispozicion të publikut për transportin e pasagjerëve, postën, dhe / ose ngarkesa dhe (ii) është vërtetuar për qëllime të tilla nga autoriteti i aviacionit civil të shtetit në të cilin është themeluar.

Shërbimi ajror i pasagjerëve: Shërbimi ajror i planifikuar ose jo i planifikuar i kryer nga aeroplanët që transportojnë një ose më shumë pasagjerë të ardhur dhe çdo fluturim të listuar në oraret e publikuara si të hapura për pasagjerë.

Shërbimi ajror i mallrave dhe i postës: Shërbimi ajror i planifikuar ose jo i planifikuar, i kryer nga aeroplanët që mbajnë ngarkesa të ardhura (mallrave dhe postës), përveç pasagjerëve.

Numri i fluturimeve: Është numri i parë fillestar i publikuar i caktuar nga operatori i transportit ajror në fluturim. Pasagjerët që përdorin një fluturim nga një aeroplan mund të udhëtojnë nën një sërë numrash të ndryshëm fluturimesh.

Pasagjerë të transportuar: Quhen të gjithë pasagjerët udhëtimi i të cilëve fillon ose mbaron në aeroportin raportues.

Mallrat e transportuar: Përfshijnë çdo ngarkesë e ngarkuar në avion ose e shkarkuar prej tij, duke përfshirë bagazhet e pasagjerëve dhe postën.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Instituti i Statistikave

Transporti në shifra 2021 = Transport in figures 2021 :

INSTAT ; drejt. bot. Elsa Dhuli.

- Tiranë : INSTAT, 2023

... f. : me il. ; ... cm.

ISBN 978-9928-390-03-5

1.Transporti 2.Statistika 3.Shqipëri

311.312(496.5) "2021" :656



TRANSPORTI NË SHIFRA

2021